

Fillimi > -Kronikë

Grabitet banesa në Vaun e Dejës, autorët përballen me pronarin dhe i drejtojnë armën, marrin 5 mln lekë dhe kamerat e sigurisë

Senad Nikshiqi | 02 Qershor, 2021 14:51



Madhësia e tekstit: - +

Tre persona të armatosur dhe me maska kanë grabitur një shumë të konsiderueshme prej 5 milionë lekësh të vjetër në fshatin Stajkë të bashkisë Vau Dejës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 3 të mëngjesit të sotëm, teksa grabitësit kanë marrë shumën prej 5 milionë lekësh të vjetër në banesën e shtetasit Pashk Meli. Grabitësit, teksa kanë qenë duke dalë pasi kanë marrë shumën e parave, për një moment i kanë drejtuar armën djalit të shtëpisë, Pashk Melit.

Grabitësit nuk kanë folur asnjë fjalë, por vetëm njëri prej tyre i ka drejtuar pistoletën të riut dhe janë larguar me shpejtësi. Më përpara tre personat e armatosur kanë marrë edhe serverin e kamerave të sigurisë të kësaj banese, duke u siguruar që të mos lënë asnjë gjurmë gjatë grabitjes. Pashk Meli së bashku me babain dhe nënën e moshuar ndodheshin brenda në shtëpi në momentin kur ka ndodhur grabitja.

Fillimisht ata nuk kanë dëgjuar asgjë, por pak përpara se të largohen e zonja e shtëpisë dhe djali i saj, Pashk Meli, kanë dëgjuar zhurmën dhe janë zgjuar, por i riu është përballur me armën e drejtuar dhe nuk ka mundur që të bëjë asnjë lloj reagimi. Shuma e parave prej 5 milionë lekësh të vjetër ndodhej në një arkë të madhe që kishte e zonja e shtëpisë.

Ajo paratë i kishte futur në arkën ku mbante edhe rrobat. Mesa duket autorët e grabitjes kanë pasur informacion të sigurt, pasi kanë shkuar direkt tek arka, duke e nxjerrë jashtë dhe duke marrë paratë brenda saj. Autorët sipas të zotëve të shtëpisë kanë hyrë në oborr dhe më pas përmes një dritareje pas shtëpisë janë futur brenda banesës. Pasi janë futur brenda, fillimisht dyshohet se janë ngjitur përmes shkallëve të brendshme të shtëpisë, duke marrë kamerat e sigurisë dhe më pas janë ulur poshtë, duke grabitur edhe shumë e parave prej 5 milionë lekë të vjetër, që ndodheshin brenda arkës me rroba.

Familja Meli ka bërë denoncim në postën e policisë në Barbullush, pjesë e policisë vendore të Shkodrës, duke treguar se çfarë ka ndodhur. Policia ka mbërritur në vendngjarje, duke nisur hetimet, por deri më tani nuk ka asgjë konkrete për zbulimin e grabitësve. Nga kamerat e sigurisë të subjekteve aty afër shihet vetëm momenti i ardhjes me një mjet, por nuk dihet se nga kanë ikur, pasi kanë kryer grabitjen. Vjedhjet dhe grabitjet në Shkodër kohët e fundit janë shtuar ndjeshëm në banesa, duke krijuar një lloj frike tek qytetarët.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: grabitje pashk meli Vau i Dejës

TË NGJASHME

Policia greke nxjerr fotot dhe emrat, kjo është 22-vjeçarja që bashkëpunonte me bandën greke
26 Maj, 2021

Krimi në Greqi, bashkëshorti i 20-vjeçares braktis shtëpinë, vendos të jetojë diku tjetër me foshnjen 11-muajshe
25 Maj, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

"Shkoi Pirro Mani dhe mori me vete gjithë dashurinë", aktorja kujton vitet e punës me regjisorin: Sot Teatri mbeti i zbrazët!
03 Qershor, 2021

Rrëzohet nga 2 metra lartësi 17-vjeçari në Sarandë, pëson fraktura të rënda në kokë e trup, transportohet me helikopter në Tiranë
03 Qershor, 2021

Ndryshimet ligjore/ Gjykata e Lartë takim online, Sadushi: Rritje e përgjegjësisë. Ambasadorja e SHBA: Moment i rëndësishëm historik për reformën në drejtësi
03 Qershor, 2021

U dërgua me helikopter në Tiranë, Policia: 17-vjeçari ra nga një ndërtesë në Ksamil, po kryente punime hidraulike
03 Qershor, 2021

Çifti Anagnosti, mesazh lamtumire për Pirro Manin: Janë të rrallë regjisorë të tillë, i dha vlera të pazëvendësueshme artit!
03 Qershor, 2021

U kapën me tritol, armë e granata, lihen në burg tre të arrestuarit e operacionit "Binomi"
03 Qershor, 2021

KATEGORIA VIDEO

Shkarkimi i Metës/ Vasjari: Sjelljet e Presidentit nuk tregojnë simbol të unitetit kombëtar, nëse ka pakënaqësi me mazhorancën, të dalë nga sistemi e t'i bëjë ballë
03 Qershor, 2021


Shkarkimi/ Rakipllari: Presidentin po e gjykojnë për mendimet e tij. Nëse ka një shkelje, është ajo për ambasadorën e SHBA, por...
03 Qershor, 2021

"Gjejini ku të jenë", Alket Hyseni: Pas deklaratës në Elbasan të Presidentit u vra një patronazhist me armë nga grupet paramilitare, nuk u dënua kurrë nga Meta
03 Qershor, 2021

Hyseni: Po të kishte mekanizmat, Meta bënte grusht shteti! Vasjari: Presidenti duhet të jetë Kreu i Shtetit jo vetëm në situata të zakonshme!
03 Qershor, 2021

"Situata ka agravuar", Vasjari: Presidenti duhet shkarkuar, ka shkelur nenin 86 të Kushtetutës dhe betimin e bërë
03 Qershor, 2021

Shkarkimi i Metës, Alket Hyseni: Të gjitha faktet që tregojnë se Presidenti ka shkelur Kushtetutën dhe ligjet me të dyja këmbët!
03 Qershor, 2021




Kerko ketu


LAJMET E FUNDIT



Lista/ 182 mln euro investime buxhetore në 4-mujor, PPP-të, zgjedhjet, rindërtimi dhe bujqësia më të financuarat
04 Qershor, 2021




Horoskopi për ditën e sotme, 4 qershor 2021
04 Qershor, 2021




COVID-19, Izraeli nis vaksinimin e 12-15-vjeçarëve
04 Qershor, 2021



COVID-19, Eksperimenti/ Një qytet i tërë u vaksinua me Sinovac në Brazil dhe rezultatet ishin të shkëlqyera
04 Qershor, 2021



"Mianmar mund të bëhet epiqendra e re e COVID-19"
04 Qershor, 2021



BE-ja dhe Britania arrijnë marrëveshje për kuotat e peshkimit për vitin 2021
04 Qershor, 2021

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATESISE

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert

Emisioni Diplomaticus

Emisioni Vila 24

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Monitor Ekonomi

Real Story

Shqiptarët për shqiptarët

Sport News

Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today